



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac – Municipality of Rahovec

Drejtoria Komunale e Arsimit

Nr. prot.: 04/ 1622

Datë: 12 / 03 / 2024

Në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr. 08/L-197, neni 80 dhe 81 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, neni 8, i Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Nr. 04/L-032, të datës 29.8.2011, neni 34 dhe 35, të Ligjit për Arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-068, neni 5, paragrafi c, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it, Nr. 05/2021, për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec, shpall:

KONKURS

Për plotësimin e një (1) pozite të lirë të punës me kuadër profesional të arsimit, për vitin shkollor 2023/2024: **Mësimdhënës/e për Lëndën e Gjeografisë.**

Institucioni:	Komuna e Rahovecit
Njësia:	Drejtoria për Arsim
Shkolla:	SHML "Xhelal Hajda-Toni"
Data e njoftimit:	12.03.2024
Afati për aplikim:	13.03.2024, deri me 11.04.2024

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës:

- Të realizojë plan programin mësimor për vendin e punës, në harmoni me legjislacionin në fuqi, që të rregullojë fushat përkatëse në vendin e punës;
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencës profesionale në procesin e mësim-dhënies;
- Të përgatitë me rregull plani mësimor, në përputhje me kurrikulën bërthamë;
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe vlerësimit në përputhje me udhëzimet kurrikulare;
- Të mbajë ditarin personal të vlerësimit të nxënësve;
- Të marrë pjesë aktive në organizimet jashtë mësimore me nxënës;
- Detyrat tjera që janë të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

2. Kërkesat e përgjithshme për pranim:

- a. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- b. Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- c. Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- d. Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- e. Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- f. Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- g. Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën,
- h. Kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe
- i. Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.

3. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara nga DKA në përputhje me ligjet që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar dhe në përputhje me udhëzimet administrative përkatëse. Kandidatët e kualifikuar me drejtime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre ligjeve dhe UA-ve nuk do të merren në shqyrtim, vetëm në rast se nuk ka të kualifikuar.

4. Dokumentet e nevojshme:

- Formulari i aplikimit (i plotësuar);
- Kopjet e dokumentit personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- Kopjen e ekstraktit të lindjes;
- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore të noterizuara (*personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet t'i kenë diplomat e nostrifikuara nga MASHTI*);
- Kopjet e dëshmisë së punësimit;
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve;
- Dokumenti që nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë (*lëshuar nga Gjykata Themelore, jo më i vjetër se 6 muaj*);

5. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

- a. Testimi me shkrim (70%);
- b. Intervistë me gojë (30%).

6. Mënyra e aplikimit:

Dokumentacioni i aplikimit dorëzohet në kopje fizike së bashku me formularin e aplikimit në zyrat e DKA. Formulari i aplikimit merret në DKA, si dhe mund të shkarkohet nga linku: <https://konkursi.rks-gov.net>.

7. Sqarime shtesë:

- a. Dokumentet duhet të jenë në kopje sepse ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistës;
- b. Informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi);
- c. Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional, siç specifikohet në Ligjin për Zyrtarët Publik.
- d. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë dhe aplikacionet e mangëta nuk pranohen.



Avni Morina
Avni Morina
Drejtore